



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E JASHTËZAKONSHME SOLEMNE E KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
9 PRILL 2008

SA SVEČANE VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE
KOSOVA, ODRŽANE 9. APRILA 2008. GODINE

Prill – April
2008

Rendi i ditës:

1. Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Dnevni red:

1. Usvajanje Ustava Republike Kosova.

Agenda:

1. Approval of the Constitution of Republic of Kosovo

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E JASHTËZAKONSHME SOLEMNE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 9 PRILL 2008

Seanca filloi punën në orën 10,00.

Seancën e jashtëzakonshme plenare e drejtoi zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar, mysafirë, lus që të uleni dhe të vazhdojmë punën.

Në sallë janë të pranishëm 103 deputetë, prandaj kemi kuorumin e nevojshëm për të filluar punën.

E hap seancën dhe ju njoftoj se fjalën e ka Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi. Urdhëroni, zoti Krasniqi!

KRYETARI I KUVENDIT:

I nderuari, zoti President Sejdiu,
I nderuari Kryeministër Thaçi,
Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,
I nderuari zoti Feith,
Të nderuar mysafirë të tjerë dhe përfaqësues të përfaqësive diplomatike në Prishtinë,
Të nderuar prijës fetarë dhe përfaqësues të arsimit, të Universitetit të Kosovës,
Të nderuar kryetarë të komunave të Kosovës,
Të nderuar anëtarë të Komisionit Kushtetues,
Të nderuar shtetas të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës!

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë të hap punimet e kësaj seance të jashtëzakonshme dhe solemne të Kuvendit për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Pa kaluar dy muaj nga shpallja e pavarësisë, sot sërish jemi mbledhur në evenimentin historik të institucionalizimit të lirisë për t'i dhënë shtetit tonë ligjin themelor.

Kushtetuta e Kosovës, si dokument i rëndësishëm politik dhe juridik, është ndërtuar mbi themelet e demokracisë kushtetuese moderne.

Demokracia jonë kushtetuese siguron qeverisjen e popullit nëpërmjet të përfaqësuesve të tij të zgjedhur, përcakton qartë kompetencat institucionale dhe iu garanton të gjithë qytetarëve të Republikës, pa asnjë dallim, të drejtat themelore dhe barazinë para ligjit. Pjesë përbërëse të saj janë virtytet qytetarëve, të solidaritetit, të besimit, të tolerancës dhe të integritetit.

Demokracia është proces dinamik e arritjeve të vazhdueshme të niveleve të lirisë njerëzore dhe të pjekurisë së një shoqërie të përgjegjshme ndaj ligjit, ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve.

Kushtetuta jonë sanksionon shkallë të lartë të idealizmit të një shoqërie të lirë, të hapur, demokratike dhe sovrane. Ajo promovon dhe iu garanton të drejta dhe standarde të larta komuniteteve pakicë të Kosovës që nga sot. Të drejtat e komuniteteve nuk janë më thjeshtë vetëm vullnet i mirë dhe e deklaruar e shumicës, por kategori e përcaktuar kushtetuese dhe partneritetet solemn e publik. Ato janë të mbrojtura dhe të pacenueshme.

Të nderuar deputetë,

Duke miratuar Kushtetutën, ne kemi siguruar themele, mbi të cilat do të ngrihet shteti demokratik dhe sovran i Republikës së Kosovës.

Me Kushtetutë ne po kurorëzojmë aspiratat dhe vullnetin e popullit të Kosovës për liri, demokraci dhe përparim. Pas Deklaratës së pavarësisë, ne sot po bëjmë një deklaratë tjetër të detyrimeve zyrtare ndaj shtetit tonë të lirë, të pavarur dhe kjo deklaratë quhet: Kushtetutë.

Miratimi i Kushtetutës me vullnetin e lirë, si përfaqësues të zgjedhur të popullit të Kosovës, përbën njëkohësisht edhe betimin solemn të nënshtrimit tonë ndaj 162 neneve të saj.

Duke respektuar Kushtetutën dhe ligjin, Kosova do të dëshmojë përcaktimin e saj për demokracinë e vërtetë, do të promovojë institucionet e përgjegjshme, do ta shfaqë kulturën e saj civilizuese dhe do të jetë partner serioz ndërkombëtar. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

Në pajtim me Rregullën 23 pika 6 të Rregullores së Punës të Kuvendit, në konsultim me shefat e grupeve kuvendore, me propozim të Presidentit dhe të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, kam miratuar kërkesën për të thirrur seancën e jashtëzakonshme solemnë të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Rendi i ditës, së bashku me materialin – në pesë gjuhë, iu është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Lus deputetët që, me ngritjen e dorës, të deklarohen për rendin e propozuar të ditës.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 103 deputetë.

Prandaj, pyes: kush është “për”?

Ju faleminderit!

A ka “kundër”? Nuk ka.

Ju faleminderit!

Konstatoj se Kuvendi, me 103 vota “për” miratoi rendin e propozuar të ditës.

Tash procedojmë me rendin e propozuar të ditës.

Ftoj Presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Fatmir Sejdiu, që të marrë fjalën.

(Duartrokitje)

PRESIDENTI I KOSOVËS FATMIR SEJDIU: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,
I nderuari Kryeministër i Kosovës, zoti Hashim Thaçi,
I nderuari Përfaqësues Civil Ndërkombëtar, zoti Feith,
Të nderuar ambasadorë dhe udhëheqës të misionëve diplomatike në Kosovë,
Të nderuar deputetë dhe ministra të Republikës së Kosovës,
Të nderuar anëtarë të Komisionit Kushtetues,
Zonja dhe zotërinj,

Në radhë të parë, dëshiroj të falënderoj Kryetarin e Kuvendit, Kryesinë dhe shefat e grupeve parlamentare që kanë pranuar unanimisht iniciativën tonë të përbashkët me Kryeministrin që sot në rend dite të vendosin në një seancë solemne dhe të jashtëzakonshme miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në vazhden e zhvillimeve jashtëzakonisht të rëndësishme dhe historike për Kosovën pas shpalljes së pavarësisë dhe njohjes ndërkombëtare të saj nga një numër i madh vendesh të botës demokratike, dita e sotme, po kështu, shënon një moment të veçantë në përmbylljen e ciklit të shtetndërtimit të Kosovës.

Para dy ditësh, pas certifikimit nga ana e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, zotit Piter Feith të Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës dhe prezantimit të nënshkrimit solemn nga ana e Komisionit Kushtetues, të cilin e kam mandatuar muaj më parë, kemi kërkuar nga Kuvendi i Republikës që sot, në këtë seancë solemne dhe të jashtëzakonshme, të miratohet akti më i lartë juridik i shtetit sovran dhe të pavarur të Kosovës – Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Ky dokument, me peshën e vet të veçantë, sa mund të quhet me të drejtë përmbyllje e procesit shtetndërtues të Kosovës, po kaq, në të njëjtën kohë, në bazament të qëndrueshëm formal juridik dhe esencial, e futë Kosovën në rrafsh të ri të zhvillimeve shtetërore, politike dhe juridike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në po të njëjtën kohë, hap horizontin dhe mundësinë tonë për përballje me sfida të shumta që do të kapërcehen duke dëshmuar fuqishëm qëndrueshmërinë e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, të cilat edhe në rrugën e deritanishme kanë dëshmuar seriozitetin dhe këmbëngulësinë për veprim të suksesshëm në realizimin e interesave të qytetarëve të Republikës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si projekt i ofruar para jush, ka dy dimensionë të rëndësishme që e përcjellin gjithë strukturën e saj të brendshme duke u shtruar si gërshet i suksesshëm i parimeve më të rëndësishme të ndërtimit të kushtetutave bashkëkohëse, por

edhe si vëmendje e posaçme kushtuar pozitës së individit dhe të qytetarit të Republikës së Kosovës mbi bazë të standardeve më të larta ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Komisioni Kushtetues, në këtë projekt ka arritur që suksesshëm të bëjë inkorporimin e zotimeve themelore që institucionet e Kosovës, pra ky Kuvend, si sovran i popullit, kanë vënë në relacion me dokumentin më të rëndësishëm të procesit ndërkombëtar për statusin e Kosovës, Propozimin gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari.

Andaj, garancitë e dhëna për pozitën e komuniteteve pakicë shprehin, po kështu, qëndrimin e qartë të institucioneve të Kosovës për zbatimin e tyre në jetën praktike si pjesë e dëshmisë dhe e përkushtimit të qytetarëve të shumicës, por edhe të vetë institucioneve për ndërtimin e Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur, si atdhe i të gjithë qytetarëve, pa dallim etnie.

Kjo është qasja fundamentale që Kosova ka ndaj njerëzve të saj, duke hapur me këtë paralelisht horizontin e ri të qasjes së vet për ta shpejtuar hapin drejt procesit të integritimeve Euroatlantike, gjithmonë duke pasur parasysh parimin se larmia shumetnike e një vendi dhe respekti i veçantë ndaj pakicave paraqet begati dhe vlera në përmasa universale dhe që sjell respektin e ndërsjellë në botën demokratike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, thënë më së thjeshti, është çelësi themelor mbi të cilën do të mbështeten zhvillimet e mëvonshme edhe të ndërtimit, edhe të funksionimit të institucioneve demokratike të Kosovës, edhe të zbërthimit të veprimtarisë së tyre në një korpus të veçantë mbështetës legjislativ që duhet të pasohet me një numër të pandërprerë të ligjeve që mbulojnë dhe rregullojnë të gjitha fushat e jetës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, bashkë me ligjet që do të derivohen nga kjo Kushtetutë, do të jetë garancia kryesore e ndërtimit të Kosovës si shtet i mirëqenies ekonomike, i cili do të zhvillohet edhe më tej në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe të konkurrencës së lirë e të drejtë.

Me miratimin e kësaj Kushtetute dhe të ligjeve bazike që promovojnë këto parime dhe investimet e jashtme, do të hapin mundësi të reja për shfrytëzimin e potencialeve që Kosova ofron dhe për hyrjen e saj në Evropë si shtet i qëndrueshëm ekonomikisht.

Mbi bazën e këtyre parimeve dhe duke pasur parasysh ndërtimin e gjithë strukturës institucionale përgjegjëse për zbatimin e tyre, Republika e Kosovës do të kapërcejë më shpejt edhe rrugën drejt integritit të saj në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Të nderuar deputetë,

Në këtë ditë solemne duhet të shpreh konsideratat e mia më të larta për punën e suksesshme që ka bërë Komisioni Kushtetues, për nivelin e lartë të bashkëpunimit të ndërsjellë që kanë pasur përfaqësuesit e të gjitha partive politike dhe të shoqërisë civile, duke rezultuar me një gërshet të mirë të ideve dhe ekspertizës të gjithë anëtarëve dhe

duke dëgjuar gjithashtu edhe zërin e qytetarëve të Republikës së Kosovës gjatë periudhës së konsultimeve publike për tekstin e Projektkushtetutës.

Gjithashtu, shpreh falënderimet dhe mirënjohjen time për përkrahjen pa rezervë të ekspertëve ndërkombëtarë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zyra Civile Ndërkombëtare dhe të gjitha shtetet mike të Kosovës, të cilët, njëjtë sikur edhe në të gjitha fazat e mëhershme të rëndësishme për vendin tonë, na mbështetën edhe në përgatitjet për këtë akt të ndërtimit të Republikës së Kosovës.

Përfundimisht, ju uroj juve, të nderuar deputetë dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës që kemi privilegjin t'i takojmë kësaj gjenerate që po miratojmë aktin më të lartë juridik të shtetit më të ri të botës pas sakrificave të brezave të shumtë për këtë ditë të rëndësishme. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, President!

Ftoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,

I nderuari President i Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu,

I nderuari zoti Piter Feith,

Të nderuara dhe të nderuar shefa të zyrave diplomatike në Kosovë,

Të nderuar deputetë, ministra,

Të nderuar mysafirë,

Zonja dhe zotërinj ministra,

Më 17 shkurt 2008, në këtë Kuvend të respektuar, ne e shpallëm Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Ky vendim historik dhe i papërsëritshëm, u përcoll me njohjen e shtetit të Kosovës nga shtetet më të fuqishme dhe demokratike të botës.

Kështu, ne krijuam realitet të ri dhe ky realitet do të marrë mbështetje edhe më të fuqishme dhe më masive sot me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Të nderuar të pranishëm,

Falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit Kushtetues, dhe ju, i nderuari Kryetar - zoti Kuçi, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë për punën e mrekullueshme që e kanë bërë.

Prandaj, sot Kosova po bëhet me Kushtetutën e vet dhe Kushtetutën e shtetit të pavarur, sovran, demokratik, unik dhe të pandashëm.

Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, prandaj kjo Kushtetutë është e jona.

Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitet tjera. Vlerat fundamentale dhe liritë e të gjitha kombeve demokratike janë të mbrojtura me anë të Kushtetutës. Prandaj, edhe ne sot kemi vendosur që ta ndjekim rrugën e shteteve të lira dhe demokratike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është vullneti ynë, është legjitimiteti dhe vula e shtetit të Kosovës.

Këtë që po bëjmë ne sot, është edhe një hap përpara tjetër historik në rrugën tonë për të ndërtuar shtetin tonë të qëndrueshëm, me qeverisje stabile dhe demokratike - Kosovën e pavarur, sovranë dhe krenare.

Duke e miratuar këtë Kushtetutë, ne vendosim për të drejtat e qytetarëve tanë dhe përgjegjësitë e qeverisë sonë, të cilat janë themele të zhvillimit të vendit tonë.

Kushtetuta jonë nuk është imitim i formave të tjera të qeverisjes. Kjo Kushtetutë, që po e miratojmë sot, është vetë evoluimi i historisë sonë të përbashkët.

Kushtetuta jonë e përcakton qartë shpresën, optimizmin, besimin dhe të drejtat tona të cilat ne fuqimisht i mbështesim dhe të cilat na mbajnë të bashkuar.

Kushtetuta jonë do ta mbajë vendin dhe popullin tonë të bashkuar, sepse të bashkuar do të na mbajnë vlerat.

Kushtetuta jonë iu mundëson qytetarëve tanë që të marrin frymë në mënyrë të barabartë përpara ligjit. Ajo i mbron privilegjet e drejta dhe liritë e gjithë shtetasve, pavarësisht përkatësisë etnike, religjionit apo bindjeve politike.

Legjitimiteti i qeverisjes sonë buron nga pajtueshmëria e çdo qytetari tonë për të qeverisur në mënyrë të drejtë.

Kushtetuta jonë nuk është dokument që iu thotë atyre se çfarë mund të bëjë ajo vetë, por ajo iu tregon qytetarëve se çfarë mund të bëjë Qeveria, ndërsa Qeveria nuk mund të bëjë asgjë më shumë nga ajo çfarë është përcaktuar me anë të kësaj Kushtetute.

Llogaridhënia dhe përgjegjësitë, qeverisja e kufizuar, ndarja e kompetencave - janë disa nga elementet fundamentale të sistemit kushtetues të cilat garantojnë se asnjë nga fushat e qeverisjes, si e vetme, nuk mund të sigurojë ruajtjen e të drejtave tona.

Mbrojtësi më i madh i të drejtave tona është sistemi ynë kushtetues i tërësishëm.

Në Kushtetutën tonë gjërat janë të balancuara, dhe kjo është arsyeja kryesore pse sistemi gjyqësor duhet të jetë i pavarur dhe kjo është edhe arsyeja përse ai duhet të jetë i përmbytur.

Jam shumë i bindur se Kushtetuta jonë do të jetë e qëndrueshme, do të jetojë edhe në kohë të zhvillimit, por edhe në kohë të vështira.

Kushtetuta jonë nuk do të ekzistojë thjeshtë si një plan për qeverisje. Ky dokument që po e miratojmë sot, do të jetë gjithmonë diçka më tepër për ne, diçka e mbushur me një ndjenjë më të thellë, e jo vetëm një admirim i thjeshtë.

Kjo Kushtetutë është një marrëveshje, që po e bëjmë, jo vetëm për veten tonë, por për të gjithë njerëzit tanë.

Në rrugën tonë për liri, drejtësi dhe demokraci, ne kurrë nuk kemi qenë të vetmuar. Përkrahje vazhdimisht kemi pasur dhe do t'i kemi miqtë tanë ndërkombëtar, të cilët mbështesin fuqishëm dëshirën dhe vullnetin tonë për t'i mbrojtur dhe avancuar vlerat e përbashkëta të qytetërimit.

Unë ju shpreh falënderimin dhe mirënjohjen më të thellë në emër të qytetarëve të Kosovës për gjithçka që kanë bërë dhe po bëjnë për vendin tonë.

Kohët që po i jetojmë, janë vërtetë historike. Ne nuk i përcjellim ngjarjet, por kështu bashkë dhe unik po e bëjmë historinë tonë më të re. Dhe natyrisht, librat e historisë do të shkruajnë për gjërat që po i bëjmë ne sot, të gjithë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë tonë. Secili nga ne ka të drejtë të ndihet krenar që është pjesë e kësaj ngjarjeje të madhe dhe përgjegjësia jonë është që çdo qytetar të Kosovës ta bëjmë krenar në shtetin tonë të pavarur, sovran dhe demokratik.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron edhe më tepër Kosovën me NATO-n dhe Bashkimin Evropian.

Prandaj, të nderuara zonja dhe zotërinj, unë jam krenar që jam i pranishëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe si Kryeministër i Qeverisë së pavarësisë së Kosovës, kam mundësinë që t'ju ftoj ta miratojmë njëzëri Kushtetutën tonë, e cila do të mbetet përgjithmonë testament i guximit dhe i dëshirës për liri. Te populli ynë do të mbetet përgjithmonë testament për një jetë më të mirë për të gjithë. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Ju faleminderit, Kryeministër!

Ftoj kryetarin e Komisionit Kushtetues, zotin Hajredin Kuçi, të paraqet arsyetimin e Projektkushtetutës së Republikës së Kosovës.

(Duartrokitje)

HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit zoti Kryetar!

I nderuari President,

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Zoti Feith,

Të nderuar përfaqësues vendorë dhe ndërkombëtarë,

Anëtarë të Qeverisë,
 Kryetar të komunave,
 Të dashur anëtarë të Komisionit Kushtetues,

Ndihem me fat sot që në emër të Komisionit Kushtetues të Republikës së Kosovës kam kënaqësi të veçantë në jetën time si njeri, por edhe si vend, që për herë të parë në Kosovën e pavarur dhe sovranë, para jush, deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës, para qytetarëve të Republikës sonë të dashur dhe botës demokratike, do ta prezantojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sot, me këtë akt më të lartë të shtetit tonë, ne po e çmojmë luftën e bërë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ne po e marrim përgjegjësinë për ta ndërtuar të ardhmen për të gjithë ne dhe gjeneratat që vijnë në shtetin tonë sovran, modern dhe demokratik.

Të nderuar deputetë,
 Ne, në Komisionin Kushtetues të Republikës së Kosovës, gjatë punës sonë, kemi çmuar rrugëtimin tonë të plotë, me plotë sakrifica dhe tragjedi, por edhe krenarinë si popull dhe si njerëz gjatë shekullit që shkoj. Kemi çmuar të gjithë ata që kishin për synim lirinë, pavarësinë, barazinë, demokracinë, Republikën dhe Kushtetutën dhe që ranë në altarët e lirisë. Ju kemi çmuar juve në këtë sallë dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët morën pjesë aktive në shtetndërtimin e Republikës sonë, dhe në veçanti edhe botën demokratike që e përkrahu paqen, drejtësinë, lirinë, pavarësinë dhe demokracinë në Kosovë.

Ky rrugëtim mundësoi ta bëjmë këtë Kushtetutë, që po e miratojmë sot. Prandaj, ne si Komision Kushtetues i Republikës, punën tonë në hartimin e Kushtetutës dhe këtë Kushtetutë, ua dedikojmë qytetarëve të Republikës sonë të rënë dhe të gjallë.

Deputetë të nderuar,
 Zonja dhe zotërinj,
 Më lejoni që të prezantoj shkurtimisht përmbajtjen e Kushtetutës sonë, e cila ka 14 kapituj dhe 162 nene.

Kemi synuar ta kemi një Kushtetutë moderne, të shkurtër, të qartë dhe të kuptueshme - që garanton vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe zotimet ndërkombëtare dhe që është shumë funksionale.

Sot, në duart tuaja është Drafti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si bazë e ndërtimit të sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror në shtetin tonë, për të cilin kemi shprehur synimet tona në emër të popullit të Kosovës për të ardhmen e vendit tonë të lirë, demokratik dhe paqedashës si vend i të barabartëve

Kushtetuta jonë fuqizon Republikën tonë si shtet të pavarur, sovran, demokratik, unik dhe të pandashëm.

Sovranitetin e Republikës sonë Kushtetuta e përcakton sepse buron nga populli dhe i takon atij. Ajo garanton integritetin territorial të Kosovës si të pacenueshëm, të patjetërsueshëm dhe të pandashëm dhe mund të mbrohet me të gjitha mjetet e lejuara.

Republika e Kosovës është ndërtuar mbi bazën e konceptit të barazisë qytetare dhe e definuar si shoqëri shumë etnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, ku qeveriset në mënyrë demokratike dhe respektohet plotësisht sundimi i ligjit dhe barazia e qytetarëve para tij.

Kosova jonë është definuar Republikë demokratike, e bazuar në parimin e ndarjes së pushtetit dhe të kontrollit të baraspeshës ndërmjet tyre, duke definuar Kuvendin si organin më të lartë legjislativ, Presidentin e Republikës si përfaqësues të unitetit të popullit dhe garantues të funksionimit demokratik të institucioneve dhe me një qeveri të përgjegjshme për zbatimin e ligjeve dhe të politikave shtetërore që i përgjigjet kontrollit parlamentar.

Me këtë Kushtetutë kemi institucionalizuar pushtetin, por edhe kemi bërë kufizimin e tij.

Me kushtetutën tonë, shteti ynë ka një rend kushtetues që bazohet me parimet e paqes, të lirisë, të demokracisë, të barazisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të Ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës në pronë, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ekonomisë së hapur të tregut.

Republika jonë do të jetë shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare.

Shtetasit tanë, brenda dhe jashtë Kosovës, do t'i gëzojnë garancitë kushtetuese dhe kujdesin e shtetit të tyre.

Republika jonë si subjekt ndërkombëtar, ka mundësi të bëjë marrëveshje ndërkombëtare dhe të anëtarësohet në mekanizma ndërkombëtarë. Ne kemi marrë obligime për ta respektuar të drejtën ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë një kapitull i rëndësishëm i kësaj Kushtetute, ku garantohet respektimi, mbrojtja dhe përmbushja nga ana e shtetit të Kosovës, sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

Një kapitull i veçantë janë të drejtat e komuniteteve, duke i përcaktuar parimet e këtyre të drejtave, përgjegjësitë e shtetit për këto të drejta, institucionet adekuate dhe përfaqësimin e komuniteteve në institucione publike në nivelin qendror dhe atë komunal. Këto të drejta kanë pasur si burim dokumentin e Presidentit Ahtisari.

Sistemi i drejtësisë garantohet me këtë Kushtetutë. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, i paanshëm, apolitik dhe siguron qasje të barabartë në gjykata për të gjithë.

Një institucion i ri dhe i pavarur është Gjykata Kushtetuese, si autoritet përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për Gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës sonë.

Të nderuar deputetë,

Republika e Kosovës, me këtë Kushtetutë garanton ekonominë e lirë të tregut, konkurrencën e lirë dhe siguron pronën private dhe publike, siguron të drejtat ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe ndërmarrjet vendore dhe të jashtme. Garantohej konkurrenca e lirë, mbrojtja e konsumatorëve, por edhe obligimi i qytetarëve që të paguajnë tatimet dhe kontributet e parapara me ligje.

Kushtetuta obligon që shpenzimet e financave publike dhe mbledhja e tyre duhet të bazohet në parimin e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës. Pra, taksapaguesi ynë do të njoftohet për shpenzimin publik të parave të tyre.

Edhe përdorimi i pasurisë dhe i burimeve natyrore garantohej me Kushtetutë.

Qeverisja lokale garantohej si nivel i pushtetit, që bazohet në qeverisje të mirë, transparencë, efikasitet dhe efektivitet në ofrimin e shërbimeve publike.

Republikës sonë i garantohej institucionet e plota të sigurisë, të cilat do të kenë kontroll civil dhe demokratik. Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë së Republikës sonë me të drejtë që të dërgojë trupa të saj jashtë vendit në misione paqësore. Kjo Forcë do të jetë shumetnike dhe profesionale.

Republika e Kosovës do të ketë edhe Këshillin e Sigurisë Nacionale, si institucion që përgatit strategjinë e sigurisë së Republikës sonë.

Republikës sonë i garantohej funksionimi i Policisë profesionale, Agjencionit për Inteligjencë dhe Autoritetit Civil të Aviacionit.

Institucionet e pavarura, si Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, Komisioni Qendror Zgjedhor, Banka Qendrore, Komisioni i Pavarur i Mediave, si dhe institucionet e krijuara nga Kuvendi, me të cilat garantohej pavarësia nga çdo organ apo autoritet tjetër në Republikën e Kosovës – janë disa prej institucioneve të pavarura.

Me ligj mund të themelohen edhe agjenci të tjera, që Kuvendi i konsideron si të domosdoshme.

Kjo Kushtetutë ka dispozitat përfundimtare, që i japin pasqyrën e interpretimit dhe amendamentimin e saj.

Karakteristikë e kësaj Kushtetute janë dispozitat kalimtare që normojnë gjendjen ekzistuese nën mbikëqyrjen ndërkombëtare të shtetit tonë dhe bashkëpunimin në mes të

institucioneve vendore dhe prezencës ndërkombëtare, por janë edhe një mundësi që, me kalimin e fazës së tranzicionit, këto kompetenca të përfundojnë, pra të shfuqizohen pa prekur esencën e Kushtetutës.

Është theksuar se kjo Kushtetutë hynë në fuqi më 15 qershor të këtij viti dhe nëse i lexojmë me sukses dispozitat e kësaj Kushtetute, ajo nënkupton se me hyrjen në fuqi, të gjitha institucionet ekzistuese të Kosovës marrin kompetenca të plota në përputhje me këtë Kushtetutë. Pra, kompetenca të plota shtetërore.

Të nderuar deputetë,

Ne sot po mundësojmë që të normohet ambienti dhe shteti ku jetojmë ne. Ju thërrasim për mbështetje për projektin që është bërë në përputhje me kohën e shtetndërtimit dhe të zotimeve ndërkombëtare që ka bërë Republika e Kosovës.

Besojmë shumë se kjo Kushtetutë do ta forcojë lirinë, pavarësinë, prosperitetin dhe demokracinë e shtetit tonë.

Kjo Kushtetutë mbron hapur dhe fuqishëm vlerat që duhet të sundojnë në shtetin tonë në përputhje me botën e civilizuar.

Kjo Kushtetutë do të respektojë të drejtat e secilit qytetar të Republikës duke u nisur nga premisa se asnjëherë dhe askush nuk do të jetë vërtet i lirë derisa të gjithë njerëzit nuk i gëzojnë të njëjtat liri.

Jemi inspiruar nga shumë hartues të kushtetutave të vendeve moderne dhe demokratike dhe i kemi krahasuar ato duke respektuar edhe traditën juridike të vendit tonë.

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë t'ju njoftoj juve dhe qytetarët e Kosovës se Komisioni Kushtetues i Republikës së Kosovës është përpjekur që gjithë forcën e tij njerëzore dhe intelektuale ta bartë me sukses në këtë Draftkushtetutë.

Kemi tejkaluar bindjet tona partiake e etnike dhe ka dominuar ndër ne ndjenja dhe nevoja të përbashkësisë për shtetin dhe qytetarët tanë dhe drafti, të cilin e kemi prezantuar sot, është miratuar me konsensus të plotë.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Kushtetues,

Më lejoni, në fund, që t'ju ftoj ta aprovoni këtë Kushtetutë.

Deputetë të nderuar, me bindje se është një akt bazament i shtetit tonë që forcon institucionet e Kosovës sonë dhe bindjen e bashkësisë ndërkombëtare për zotimet tona dhe jep orientimin si vend përkrah shteteve të përparuara, më lejoni të falënderoj Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Kryeparlamentarin, të gjitha partitë politike, të

gjithë qytetarët e Kosovës dhe ekspertët vendorë e ndërkombëtarë për mbështetjen e plotë, të sinqertë dhe shumë cilësore.

Në veçanti, dua t'i falënderoj anëtarët e Komisionit Kushtetues për punën e përbashkët, përkushtimin e madh, kohën e gjatë, për durimin dhe respektin që e kanë pasur për mua dhe për njeri-tjetrin, përgjegjësinë dhe mendimet cilësore që i kanë dhënë në qindra takime.

Dhe sot, sikur që kemi thënë në fillim, kemi bërë një Kushtetutë për asnjërin veç e veç, por për të gjithë ne në shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Ju faleminderit për vëmendjen!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, zoti Kuçi!
Ju njoftoj se në sallë janë prezent 107 deputetë.

Të nderuar deputetë, ju njoftoj, po ashtu, se në mbledhjen e Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare është miratuar propozimi që pas prezantimit të Kushtetutës të kalohet në procedimin e miratimit të saj.

Prandaj, propozoj që të fillojmë me votimin.
Konstatoj edhe një herë, se në sallë janë të pranishëm 107 deputetë.
Ftoj deputetët që me anë të votimit, të deklarohen lidhur me Propozimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,
Të nderuar përfaqësues të lartë të vendit dhe ndërkombëtarë,
Të nderuar të pranishëm,
Duke u bazuar në votimin me aklamacion të të gjithë deputetëve në sallë, sot, më 9 prill 2008 në orën 10,45, shpall solemnisht Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të miratuar nga 107 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

(Duartrokitje frenetike)

Ju uroj juve dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Ju faleminderit!
Të nderuar deputetë, seancën e sotme e deklaroj të mbyllur. Faleminderit dhe urime të gjithëve!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës